



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LISBONËS
PËR MBROJTJEN E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN E TYRE
NDËRKOMBËTAR”**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Marrëveshja e Lisbonës, që propozohet për aderim nëpërmjet këtij projektligji, mundëson mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të saj, përmes një regjistrimi të vetëm në zyrën ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale me seli në Gjenevë.

Kjo marrëveshje është hartuar në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë të treguesve gjeografikë, siç janë “emërtimet e origjinës” në vende të tjera, përveç vendit të origjinës, e ngjashme kjo me sistemin e Madridit për mbrojtjen ndërkombëtare të markave.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare do të ishte më i favorshëm për mbajtësit e të drejtave mbi emërtimet e origjinës, pasi me anë të një aplikimi të vetëm do të mund të shkurtrohet kohë dhe kosto për mbrojtje në 28 shtetet anëtare (aktualisht), përfshirë edhe vendet fqinje, si: Greqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia.

Sipas nenit 2 (1), të marrëveshjes, “emërtim origjine” nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësia ose karakteristikat e të cilit i atribuohen ekskluzivisht ose në thelb mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrorë dhe njerëzorë. Shqipëria është një vend që ka shumë produkte të kësaj natyre, të cilat duhen identifikuar dhe nxitur për t’u certifikuar, pasi regjistrimi kombëtar, e më tej ai ndërkombëtar, ndikojnë në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit, të trashëgimisë kulturore dhe gastronomike dhe ofrojnë mundësinë e njohjes në tregjet e huaja të produkteve karakteristike shqiptare. Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet

nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale, në Gjenevë, me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kontraktues. Kjo Zyrë mban Regjistrin Ndërkombëtar të Emërtimeve të Origjinës dhe njofton formalisht shtetet e tjera kontraktuese për regjistrimin. Gjithashtu, Zyra i publikon ato në buletin zyrtar të sistemit të Lisbonës.

Organi i ngarkuar për zbatimin e kësaj marrëveshje është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në cilësinë e institucionit përgjegjës për ndërmarrjen e nismave ligjore në fushën e njohjes dhe administrimit të të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri.

Kontributi që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale duhet të paguajë, nëse aderon në marrëveshjen e Lisbonës, varet nga një sërë faktorësh. Konkretisht, do të merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë dyvjeçarit, nëse ka, numri i vendeve anëtare në marrëveshje, klasa e kontributeve së cilës i përket Shqipëria, si edhe mënyra se si vendet anëtare të Unionit të Lisbonës vendosin të përdorin kontributet.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

Tatjana NURÇE

Eduard SHALSI